

# MARCOTECH AU 3D

FINITURË SATINE, E HOLLUESHME ME UJË AKRIL-URETHANE PËR DYSHEME BETONI  
seri 317

## PËRSHKRIMI

Finiturë monokomponente me trashësi të ulët për dysheme betoni për sipërfaqe të brendshme/jashtme.

Formulimi me bazë rezinë akril-uretane në dispersion ujor dhe pigmentosja me kolorantë me rezistencë të lartë ndaj dritës dhe zbehjes, e bëjnë MARCOTECH AU 3D ideale për ekspozime lokale, showroom-e, dhoma pritjeje, magazina jo-industriale dhe garazhe shtëpiake.

Produkti është i përshtatshëm, për më tepër, për bojatisjen e mureve të brendshme, ku kërkohet një finiturë e posaçme me rezistencë të shkëlqyer, aplikim mekanik dhe lehtësisht e pastrueshme.

-Fortësi e lartë e sipërfaqes, rezistente ndaj gerryerjes dhe shkeljeve të përsëritura, rezistente ndaj gomave të nxehta.

-Rezistencë e lartë kimike në kontaktin me benzinë, naftë dhe tretësa të ndryshëm. Pluhuri dhe yndyrnat nuk depërtojnë në finiturë, e cila mbetet e njëjtë me kalimin e kohës.

-Aderim i shkëlqyer në sipërfaqe.

-Lehtësi në pastrim.

-Shpejtësi në tharje.

## UDHËZIME PËR PËRDORIM

E aplikueshme në:

-Sipërfaqe betoni të reja ose të lyera më parë me bojra të përshtatshme dhe të aderuara.

-Suvatime gëlqereje dhe betoni të reja, ose të lyera më parë me bojë të përshtatshme dhe të aderuara.

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

-Forma e lidhësit: Kopolimer akrilik-uretan në dispersion ujor.

-Tretësi: Uji

-Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,25±0,05 Kg/l

-Shkëlqimi UNI EN ISO 2813: ≥10 këndi I leximit 85°, satin.

-Viskoziteti UNI 8902: 15000 ± 3200 cps a 25 °C (viskozimetër rrotullues Brookfield).

-Resistenca ndaj larjes UNI 10560: e shkëlqyer, >10000 cikle

-Tharja (a 25 °C e 65% di U.R.): prekja pas 60 min.; shtresa tjetër pas 5 orësh.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

### Dysheme betoni:

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe tërësisht e maturuar.

-Kontrolloni gjendjen e konsolidimit. Sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme dhe nuk duhet të prishet/copëtohet. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.

-Niveloni parregullsitë e sipërfaqes. Plasaritjet dhe uljet mund të trajtohen me produkte me bazë betoni.

-Kontrolloni gjendjen e bojës së mëparshme. Pjesët jo të aderuara duhet të hiqen.

-Hiqni ndotjet/pluhurat dhe pjesët e ciflosura duke e zmeriluar me forcë mesatare ose duke e larë me ujë.

-Në prani të mykut, trajtojeni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod 4810222 dhe me me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).

-Nëse për shkak të kushteve, është e nevojshme, përdorni si astar ATOMO 8840001.

-Aplikoni të paktën 2 shtresa të produktit të holluar aq sa duhet.

### Sipërfaqet në suva:

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë maturuar për një periudhë prej 28 ditësh.

-Kontrolloni gjendjen e konsolidimit. Sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike

-Hiqni, duke e zmeriluar ose duke e larë me ujë me presion mesatar, pluhurat prezente.

-Në prani të bojrave të vjetra, hiqni pjesët me pluhur dhe jo të mirë-aduara, ndërsa shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose tempera, duhet të hiqen tërësisht duke larë me ujë të bollshëm sipërfaqen dhe duke e fërkuar ose duke përdorur ujë me presion.

-Niveloni parregullsitë e sipërfaqes. Plasaritjet dhe uljet mund të trajtohen me BETOMARC 9450150, me RASAMIX 9440160 ose me produkte me bazë betoni.

-Niveloni çarjet dhe stukimet me letër zmerile.

-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim mesatar.

-Në prani të mykut, trajtojeni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod 4810222 dhe me restauruesin COMBAT 333 kod 4810333.

-Aplikoni astarin e mikronizuar ATOMO 8840001.

# MARCOTECH AU 3D

FINITURË SATINE, E HOLLUESHME ME UJË AKRIL-URETHANE PËR DYSHEME BETONI  
seri 317

-Aplikoni të paktën 2 shtresa të produktit, të holluar aq sa duhet.

## UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:

-Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C

-Lagështira relative e ambientit : <75%

-Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C

Sipërfaqja duhet të jetë e tharë.

Mënyra e aplikimit:

-Mjetet: pinel, rrul dhe pistoletë.

-Hollimi: 10-20% me ujë.

-Nr I shtresave: të paktën 2.

-Për të shmangur formimin e hijeve, aplikoni produktin me vazhdimësi, duke shmangur kontaktin e rrulit ose penelit, me sipërfaqen e lyer tashmë, kur produkti fillon të hidhet.

-Shkalla e mbulimit: Për sipërfaqe lisho dhe kompakte 18-20 m<sup>2</sup>/lt për shtresë. Për sipërfaqe të ashpra dhe absorbuese 12-15 m<sup>2</sup>/lt për shtresë. Këshillohet të bëni një provë paraprake në sipërfaqe specifike për të përcaktuar konsumin.

-Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë.

-Respektoni kohën e tharjes para se të kaloni shtresën e dytë.

Limitet e përdorimit:

-lagështira e sipërfaqes duhet të jetë më pak se 5%

-pH I sipërfaqes duhet të jetë më pak se 12

-për jashtë, për të garantuar jetëgjatësinë, sipërfaqja duhet të ketë pjerrësi minimale prej 1% ndaj largimit të ujit të shiut, për të shmangur stanjacionin e ujit.

-Duke qenë produkti lisho, rezistenca duhet të garantohet nga kushtet e sipërfaqes. Për të rritur rezistencën e sipërfaqes mund të shtoni MARCOTECH ADDITIVO ANTISDRUCCIOLO 0780001 në brendësi të produktit ( maksimalisht 100 g aditiv për lt të MARCOTECH AU 3D), në aplikimin e shtresës së parë.

## NGJYROSJA

Ngjyrosja mund të arrihet përmes sistemit tintometrik Marcromie. Në rast të përdorimit të fabrikimeve të ndryshme është e këshillueshme të përzihen midis tyre produktet e ndryshme për të shmangur ndryshime në tonalitete.

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C

Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C

Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite e BE-së (Direktiva 2004/42/EC) Kat. A/i: bojë monokomponente me mbulim të lartë ( bazë uji): 140 g/l (2007) / 140 g/l (2010) MARCOTECH AU 3D përmban max: 140 g/l VOC

Përdorni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë. Pas përdorimit mos I hidhni ambalazhet në ambient, lini të thahen mbetjet dhe I trajtoni ato si mbetje të vecanta. Mbajini larg përdorimit nga fëmijët. Në rast të gëlltimit konsultohuni menjëherë me mjekun dhe I tregoni ambalazhin ose etiketën. Mos hidhni mbetjet në kanalizime, korsi ujore ose në terren.

Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

## SPECIFIKIMET

Finiturë monokomponente, e hollueshme me ujë, akrilik-urethane, satine për dysHEME në beton për brenda dhe jashtë.

Aplikimi, në sipërfaqe të parapërgatitura për finiturë satine, të hollueshme me ujë për dysHEME në beton MARCOTECH AU 3D seri 317, me bazë rezinë akril-uretane në dispersion uJOR dhe pigmentoset me kolorantë që ruajnë ngjyren, në të paktën 2 shtresa në sasinë e përcaktuar nga absorbimi I sipërfaqes.

Furnizimi dhe instalimi i materialit € ..... per m<sup>2</sup>.

*SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*